



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/ Nr.155/2024  
Datë: 13 shkurt 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 dhe nenit 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe nenit 32 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2020 për Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve në takimin e mbajtur më datë 13 shkurt 2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Ndryshohet dhe Plotësohet paragrafi III i vendimit KPK/Nr.83/2024, i datës 30 janar 2024 për anëtarët rezervë të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, ku anëtarë rezervë emërohet edhe Sebahate Sinani, ashtu që komisioni do të ketë përbërje:
  1. Merita Bina-Rugova - Zëvendës kryesues;
  2. Lulzim Sylejmani – Anëtar;
  3. Sebahate Sinani- Anëtare
- II. Obligohen anëtarët rezervë të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t' i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- znj. Sebahate Sinani;
- Anëtarëve të Komisionit të KVPP-së;;
- Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.